Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada – Government*

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke/ Ministry of Education and Science

---

# UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASH) NR.137/2020 TË MËSUARIT NË VENDIN E PUNËS NË IAAP

# ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MES) No. 137/2020 WORKPLACE LEARNING IN IVET

# ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MON) BR.137/2020 UČENJE NA RADNOM MESTU U IPOO

| | | |
|---|---|---|
| **Ministri i Arsimit dhe Shkencës,** në mbështetje të nenit 6 paragrafit 3.4. të Ligjit nr. 04/I-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7 / 26 mars 2013, Prishtinë), të nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr. 06/2020, nenit 4 të Rregullores (QRK) – nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) – nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dt. 16.06.2020, nxjerr: | **Minister of Education and Science,** pursuant to Article 6 paragraph 3.4. of Law no. 04 / I-138 on Vocational Education and Training (Official Gazette of the Republic of Kosova no. 7/26 March 2013, Prishtina), Article 8 paragraph 1 subparagraph 1.4 of Regulation (GRC) no. 06/2020, Article 4 of the Regulation (GRK) - no. 07/2020 on Amending and Supplementing the Regulation (QRK) - no. 06/2020 on Areas of Administrative Responsibility of the Prime Minister's Office and Ministries, dated 16.06.2020, issue: | **Ministar obrazovanja i nauke,** u skladu sa članom 6. stav 3.4. zakona br. 04 / I-138 o profesionalnom obrazovanju i osposobljavanju (Službeni glasnik Republike Kosovo br. 7/26. Marta 2013. godine, Priština), član 8. stav 1. podstav 1.4 Uredbe (VRK) br. 06/2020, član 4. Uredbe (VRK) - br. 07/2020 o izmenama i dopunama Uredbe (VRK) - br. 06/2020 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava, dt. 16.06.2020, izdanje: |
| **UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASH) NR.___/2020 TË MËSUARIT NË VENDIN E PUNËS NË IAAP** | **ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MES) No. ___/2020 WORKPLACE LEARNING IN IVET** | **ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MON) BR.____/2020 UČENJE NA RADNOM MESTU U IPOO** |
| **Neni 1**<br>**Qëllimi** | **Article 1**<br>**The purpose** | **Član 1**<br>**Cilj** |
| Me këtë Udhëzim administrativ, rregullohet mënyra e organizimit, zbatimit dhe vlerësimit të mësuarit në vendin e punës (MVP) për nxënësit/kandidatët e IAAP-së. | With this Administrative Instruction is regulated the manner of organization, implementation and evaluation of workplace learning (WPL) for students / candidates of IVET. | Ovim administrativnim uputstvom, uređuje se način organizovanje, sprovođenja i ocenjivanje učenja na radnom mestu (URM) za učenike / kandidate IPOO. |

| Neni 2<br>Terminologjia | Article 2<br>Terminology | Član 2<br>Terminologija |
|---|---|---|
| 1. Terminologjia e përdorur në këtë Udhëzim administrativ do të ketë kuptimet e përcaktuara si në vijim: | 1. The terminology used in this Administrative Instruction shall have the meanings specified as follows: | 1. Terminologija korišćena u ovom Administrativnom uputstvu imaće značenja kao u nastavku: |
| 1.1. Arsimi dhe aftësimi profesional (AAP) - synon të pajisë nxënësit/kandidatët me njohuri, aftësi praktike, shkathtësi dhe kompetenca të kërkuara në profesione të veçanta apo më gjerë në tregun e punës; | 1.1. Vocational Education and Training (VET) - aims to equip students / candidates with knoWPLedge, practical skills, agility and competencies required in specific professions or beyond in the labor market; | 1.1. Profesionalno obrazovanje i osposobljavanje (POO) - ima za cilj da opremi učenike / kandidate znanjem, praktičnim sposbnostima, veštinama i kompetencijama traženim u određenim profesijama ili šire na tržištu rada; |
| 1.2. Institucioni i arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP) - institucion publik ose privat, që zbaton programe të arsimit dhe aftësimit profesional, në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/ L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional; | 1.2. Vocational Education and Training Institution (IVET) - a public or private institution that implements vocational education and training programs, in accordance with the provisions of Law no. 04 / L-138 on Vocational Education and Training; | 1.2. Institucija za profesionalno obrazovanje i osposobljavanje (IPOO) - javna ili privatna institucija koja sprovodi programe profesionalnog obrazovanja i osposobljavanja, u skladu sa odredbama Zakona br. 04 / L-138 o profesionalnom obrazovanju i osposobljavanju; |
| 1.3. Ndërmarrja - subjekt afarist që është i regjistruar në bazë të ligjit në fuqi; | 1.3. Enterprise - a business entity that is registered under law in force; | 1.3.Preduzeće - poslovni subjekt koji je registrovan prema važećem zakonu; |
| 1.4. Kualifikimi – njohje zyrtare e të arriturave, me të cilin njihet përfundimi i arsimit ose aftësimit, ose realizimi i kënaqshëm në një test ose provim. | 1.4. Qualification - official recognition of achievements, by which the completion of education or training, or satisfactory performance in a test or exam is recognized. | 1.4. Kvalifikacija - službeno priznavanje dostignuća, kojim se priznaje završetak obrazovanja ili osposobljavanje ili zadovoljavajuća realizacija na testu ili ispitu. |
| 1.5. Mësimi praktik - mënyra nëpërmjet së | 1.5. Practical learning - the way in | 1.5. Praktična nastava - način putem kojeg |

| | | |
|---|---|---|
| cilës nxënësit/kandidatët zhvillojnë të kuptuarit e tyre mbi zbatimin dhe përdorimin e shkathtësive dhe mënyrën e funksionimit të mjeteve dhe pajisjeve, për zbatimin e njohurive të tyre; | which students / candidates develop their understanding of the application and use of skills and the way tools and equipment work to apply their knoWPLedge; | učenici / kandidati razvijaju svoje razumevanje o primene i upotrebi veština i način funkcionisanja opreme i alata, za primenu svog znanja; |
| 1.6. Të mësuarit në vend të punës - është një formë e arsimit dhe aftësimit profesional (AAP) dual për arritjen e kualifikimit profesional, i cili organizohet në partneritet mes ndërmarrjeve private e publike dhe institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP). | 1.6. Workplace learning - is a dual form of vocational education and training (VET) for achieving vocational training, which is organized in partnership between private and public enterprises and vocational education and training institutions (IVET). | 1.6. Učenje na radnom mestu - je dualni oblik profesionalnog obrazovanja i osposobljavanja (POO) za postizanje profesionalnih kvalifikacija, koje se organizuje u partnerstvu između privatnih i javnih preduzeća i institucija za profesionalno obrazovanje i osposobljavanje (POO). |
| 1.7. Plani i MVP-së - është dokumenti i cili zhvillohet nga mësimdhënësi përgjegjës për modulet praktike profesionale në bashkëpunim të ngushtë me personin përgjegjës/ instruktorin e ndërmarrjes, duke u bazuar në fushëveprimtarinë dhe kapacitetin e saj për zbatimin e një apo disa moduleve praktike profesionale të kurrikulës së kualifikimit përkatës. Përmes këtij dokumenti, instruktori në ndërmarrje mbikëqyrë nxënësin gjatë MVP-së dhe e vlerëson atë në vazhdimësi. | 1.7. WPL (workplace) plan - is the document which is developed by the teacher responsible for the practical professional modules in close cooperation with the responsible person / instructor of the enterprise, based on its scope and capacity for the implementation of one or several practical professional modules of the respective qualification curriculum. Through this document, the instructor in the enterprise supervises the student during the WPL and evaluates him / her continuously. | 1.7. Plan URM-a je dokument koji odvija nastavnik odgovoran za praktične profesionalne module u bliskoj saradnji sa odgovornom osobom / instruktorom preduzeća, na osnovu njegovih oblasti delovanja i njenog kapaciteta za primenu jednog ili više praktičnih profesionalnih modula kurikuluma relevantne kvalifikacije. Kroz ovaj dokument, instruktor preduzeća u nadgleda učenika tokom URM-a i kontinuirano ga ocenjuje. |
| 2. Personi përgjegjës i IAAP-së për MVP-caktohet nga drejtori i IAAP-së dhe është | 2. Person in charge of IVET for WPL- is appointed by the Director of the IVET and is | 2. Lice odgovorno za IPOO za URM-imenuje direktor IPOO-a i odgovoran je za |

| | | |
|---|---|---|
| përgjegjës për promovimin e MVP-së tek përfaqësuesit e tregut të punës/ndërmarrësit si dhe identifikimin e ndërmarrjeve që shprehin interesim për të bashkëpunuar në zbatimin e MVP-së. Personi përgjegjës mund të jetë: | responsible for promoting WPL to the labor market representatives / entrepreneurs as well as identifying enterprises that express interest in cooperating in the implementation of WPL. The person in charge may be: | promovisanje URM-a predstavnicima / preduzetnicima na tržištu rada, kao i za identifikovanje preduzeća koja pokazuju zainteresovanost za saradnju u primeni URM-a. Odgovorna lice može da bude: |
| 2.1. Zyrtari i Qendrës së Karierrës; | 2.1. Career Center Officer; | 2.1. Službenik centra za karijeru; |
| 2.2. Koordinatori përgjegjës për punë praktike; | 2.2. Coordinator responsible for practical work; | 2.2. Koordinator odgovoran za praktičan rad; |
| 2.3. Zëvendësdrejtori përgjegjës për ndërlidhje me tregun e punës. | 2.3. Deputy Principal responsible for liaison to the labor market. | 2.3. Zamenik direktora odgovoran za vezu na tržištem rada. |
| 3. Mësimdhënësi i praktikës profesionale/instruktori i IAAP-së - personi i licencuar, i angazhuar në dhënien e mësimit praktik në institucionet e akredituara dhe licencuara të arsimit dhe aftësimit profesional. | 3. Professional practice teacher / IVET instructor - licensed person, engaged in providing practical training in accredited and licensed institutions of vocational education and training. | 3. Nastavnik profesionalne prakse / instruktor IPOO - licencirana osoba, angažovana za predavanje praktične nastave u akreditovanim i licenciranim institucijama za profesionalno obrazovanje i obuku. |
| 4. Instruktori/personi përgjegjës në ndërmarrje, është personi përgjegjës i caktuar nga ndërmarrja i cili e udhëzon nxënësin gjatë realizimit të MVP-së. | 4. Instructor / responsible person in the enterprise, is the responsible person appointed by the enterprise who guides the student during the implementation of WPL. | 4. Instruktor / odgovorno lice u preduzeću je odgovorno lice imenovano od strane preduzeća koje upućuje učenika tokom realizacije URM-a. |
| 5. Nxënësi – çdo person i regjistruar në çfarëdo programi të arsimit dhe aftësimit profesional në shkollat profesionale. | 5. Student - any person enrolled in any vocational education and training program in vocational schools. | 5. Učenik - svaka osoba upisana u bilo koji program profesionalnog obrazovanja i osposbljavanja u profesionalnim školama. |
| 6. Kandidati - është çdo person, që kërkon | 6. Candidate - is any person who seeks to | 6. Kandidat - je svaka osoba koja želi da |

| | | |
|---|---|---|
| të certifikohet për të arriturat në mësim të përvetësuara qoftë nëpërmjet mësimit formal, joformal ose atij informal.<br><br>7. Portofolio e nxënësit/kandidatit – është dokument i cili përmban të gjitha dëshmitë nga realizimi i MVP-së.<br><br>**Neni 3**<br>**Të mësuarit në vendin e punës**<br><br>Të mësuarit në vendin e punës është një formë e arsimit dhe aftësimit profesional (AAP) dual për arritjen e kualifikimit profesional, i cili organizohet në partneritet mes ndërmarrjeve private e publike dhe institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP).<br><br>**Neni 4**<br>**E drejta për të ofruar të mësuarit në vendin e punës**<br><br>1. Të gjitha institucionet, ndërmarrjet publike dhe private, të cilat i plotësojnë kriteret, kanë të drejtë të ofrojnë të mësuarit në vendin e punës.<br><br>2. Përcaktimi i kritereve për të ofruar MVP, bëhet nga MASH, OEK, organizatat përfaqësuese të ndërmarrjeve dhe partnerët | be certified for learning achievements acquired through formal, non-formal or informal learning.<br><br>7. Student / candidate portfolio - is a document which contains all the evidence from the implementation of WPL.<br><br>**Article 3**<br>**Workplace learning**<br><br>Workplace learning is a dual form of vocational education and training (VET) for achieving vocational qualification, which is organized in partnership between private and public enterprises and vocational education and training institutions (IVET).<br><br>**Article 4**<br>**The right to provide workplace learning**<br><br>1. All institutions, public and private enterprises, which meet the criteria, have the right to offer workplace learning.<br><br>2. Determining the criteria for providing WPL is done by MES, KCC, representative organizations of enterprises and social | bude sertifikovana da postigne stečeno učenje formalnim, neformalnim ili informalnim učenjem.<br><br>7. Portfolio učenika / kandidata - je dokument koji sadrži sve dokaze tokom realizacije URM-a.<br><br>**Član 3**<br>**Učenje na radnom mestu**<br><br>Učenje na radnom mestu je dualni oblik profesionalnog obrazovanja i osposobljavanja (POO) za postizanje profesionalnih kvalifikacija, koje se organizuje u partnerstvu između privatnih i javnih preduzeća i institucije za profesionalno obrazovanje i osposobljavanje (POO).<br><br>**Član 4**<br>**Pravo na omogučavanje učenje na radom mestu**<br><br>1. Sve institucije, privatna i javna preduzeća, koje ispunjavaju kriterije, imaju pravo da omoguće učenje na radnom mestu.<br><br>2. Određivanje kriterijuma za pružanje URM, vrši MON, PKK, predstavničke organizacije preduzeća i socijalni partneri. |

| | | |
|---|---|---|
| social. | partners. | |
| **Neni 5**<br>**Organizimi i të mësuarit në vendin e punës** | **Article 5**<br>**Organizing workplace learning** | **Član 5**<br>**Organizovanje učenja na radnom mestu** |
| 1. Organizimi i MVP-së, bazohet në kërkesat e kurrikulës së kualifikimit përkatës. | 1. The organization of WPL is based on the requirements of the respective qualification curriculum. | 1. Organizovanje URM-a se zasniva na zateve relevantnog kvalifikacionog kurikuluma. |
| 2. MVP ofrohet sipas marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të IAAP-së dhe një ose disa ndërmarrjeve, si dhe kontratës së të mësuarit në vendin e punës (MVP) ndërmjet nxënësit/kandidatit, ndërmarrjeve dhe IAAP-së. | 2. WPL is provided under a cooperation agreement between the IVET and one or more enterprises, as well as a workplace learning (WPL) contract between the student / candidate, enterprises and the IVET. | 2. URM omogućava se u skladu sporazumom o saradnji između IPOO i jednog ili više preduzeća, kao i ugovora o učenju na radnom mestu (URM) između učenik/kandidata preduzeća i IPOO. |
| 3. Marrëveshja e bashkëpunimit rregullon obligimet dhe përgjegjësitë në mes të ndërmarrjeve dhe IAAP-së, përfshirë: planifikimin, organizimin, përfshirjen e nxënësve/kandidatëve që aftësohen, kohëzgjatjen e aftësimit, bazën materiale dhe teknike, dokumentacionin dhe kurrikulën e kualifikimit përkatës. | 3. The cooperation agreement regulates the obligations and responsibilities between the enterprises and the IVET, including: planning, organization, involvement of students / candidates who are trained, training duration, material and technical basis, documentation and relevant qualification curriculum. | 3. Sporazum o saradnji reguliše obaveze i odgovornosti između preduzeća i IPOO-a, obuhvatajući: planiranje, organizovanje, uključivanje učenika/kandidata koji se osposobljavaju, vremenski period osposbljavanja, materijalnu i tehničku osnovu dokumentaciju i odgovarajući kvalifikacioni kurikulum. |
| 4. Kontrata e MVP-së rregullon obligimet dhe përgjegjësitë e nxënësit/kandidatit, ndërmarrjeve dhe IAAP-së. | 4. The WPL contract regulates the obligations and responsibilities of the student / candidate, enterprises and the IVET. | 4. Ugovor o URM -a reguliše obaveze i odgovornosti učenik/kandata, preduzeća i IPOO-a. |
| 5. Procedurat e zbatimit të MVP-së | 5. The WPL implementation procedures | 5. Procedure primene URM-a su objašnjeni |

| | | |
|---|---|---|
| shpjegohen në udhëzuesin operacional të MVP-së.<br><br>**Neni 6**<br>**Sigurimi i cilësisë i të mësuarit në vend të punës**<br><br>Sigurimi i cilësisë i MVP-së bëhet sipas legjislacionit në fuqi të MASH dhe AKK-së.<br><br>**Neni 7**<br>**Roli dhe përgjegjësitë e IAAP-së si partner në organizimin dhe ofrimin e MVP-së**<br><br>1. IAAP është institucioni përgjegjës për organizimin e MVP-së.<br><br>2. IAAP cakton personin përgjegjës dhe e mbështetë atë për koordinimin e të mësuarit në vendin e punës.<br><br>3. IAAP siguron zbatimin e MVP-në sipas procedurave të përcaktuara në udhëzuesin operacional të MVP-së.<br><br>4. IAAP përmes mësimdhënësit të praktikës profesionale/instruktorit bashkëpunon me instruktorin/personin përgjegjës në ndërmarrje për hartimin dhe zbatimin e planit të MVP-së. | are explained in the WPL operational guide.<br><br>**Article 6**<br>**Workplace learning quality assurance**<br><br>The WPL quality assurance is done according to the legislation in force of MES and NQF.<br><br>**Article 7**<br>**The role and responsibilities of the IVET as a partner in organizing and providing WPL**<br><br>1. IVET is the institution responsible for organization of WPL.<br><br>2. IVET appoints the person in charge and supports him / her in coordinating workplace learning.<br><br>3. IVET ensures the implementation of WPL according to the procedures set out in the WPL operational guide.<br><br>4. IVET through the professional practice teacher / instructor cooperates with the instructor / responsible person in the enterprise for the drafting and implementation of the WPL plan. | u operativnom uputstvu URM-a.<br><br>**Član 6**<br>**Obezbeđivanje kvaliteta učenja na radnom mestu**<br><br>Obezbeđivanje kvaliteta URM-a vrši se u skladu sa zakonodavstvom na snazi MON-a i NOK.<br><br>**Član 7**<br>**Uloga i odgovornosti IPOO-a kao partner u organizovanju i omogučavanje URM-a**<br><br>1. IPOO je institucija odgovorna za organizovanje URM-a.<br><br>2. IPOO određuje odgovorno lice i podržava to lice u koordinaciji učenja na radnom mestu.<br><br>3. IPOO obezbeđuje održavanje URM-a u skladu sa procedurama utvrđenim u operativnom uputstvu MVP.<br><br>4. IPOO preko nastavnika / instruktora profesionalne prakse sarađuje sa instruktorom / odgovornom osobom u preduzeću za izradu i primeni URM plana. |

| | | |
|---|---|---|
| 5. Nëse modulet praktike të praktikës profesionale nuk mund të zbatohen në tërësi në një ose më shumë ndërmarrje, atëherë IAAP-ja është përgjegjëse për gjetjen e modaliteteve për zbatimin e tërësishëm te moduleve praktike profesionale të kualifikimit përkatës.<br><br>6. IAAP bën promovimin e MVP-së përmes formave të ndryshme promovuese;<br><br>7. IAAP përmes personit përgjegjës apo mësimdhënësit të praktikës profesionale identifikon ndërmarrjet e interesuara për bashkëpunim në MVP.<br><br>8. IAAP në bashkëpunim me DKA-në bën sigurimin ndaj aksidentit për nxënësin gjatë realizimit të MVP-së.<br><br>9. IAAP dhe DKA nuk merr përsipër sigurimin ndaj aksidentit për të rritur.<br><br>10. IAAP në bashkëpunim me ndërmarrjen përcaktojnë kriteret për përzgjedhjen e nxënësve/kandidatëve për MVP.<br><br>11. IAAP informon nxënësit dhe prindërit mbi mundësitë e realizimit të MVP-së në ndërmarrje. | 5. If the practical modules of the professional practice cannot be fully implemented in one or more enterprises, then the IVET is responsible for finding modalities for the full implementation of the professional practice modules of the respective qualification.<br><br>6. IVET makes promotion of WPL through different promoting forms;<br><br>7. IVET through the responsible person or professional practice teacher identifies enterprises interested in cooperation in WPL.<br><br>8. IVET in cooperation with MED makes accident insurance for the student during the implementation of WPL.<br><br>9. IVET and the MED do not take over insurance on adult accident.<br><br>10. IVET in cooperation with the enterprise determines the criteria for the selection of students / candidates for WPL.<br><br>11. IVET informs students and parents about the possibilities of WPL implementation in the enterprise. | 5. Ako se praktični moduli profesionalne prakse ne mogu u potpunosti primeniti u jednom ili više preduzeća, u tom slučaju IPOO je odgovorna za pronalaženje modaliteta za potpunu primenu praktičnih profesionalnih modula relevantne kvalifikacije.<br><br>6. IPOO promoviše URM kroz različite oblike promocije;<br><br>7. IPOO, preko odgovorne osobe ili nastavnika profesionalne prakse, identifikuje preduzeća zainteresovana za saradnju za URM-u.<br><br>8. IPOO u saradnji sa ODO-om vrše osiguranje od nezgode za učenika tokom realizacije URM-a.<br><br>9. IPOO i ODO ne preuzimaju odgovornost za slučaj nezgode odraslih.<br><br>10. IPOO u saradnji sa preduzećem utvrđuje kriterijume za izbor učenika / kandidata za URM.<br><br>11. IPOO obaveštava učenike i roditelje o mogućnostima realizacije URM-a u preduzeću. |

| | | |
|---|---|---|
| 12. IAAP përmes personit përgjegjës organizon procesin e përzgjedhjes së nxënësve/kandidatëve për MVP. | 12. IVET through the responsible person organizes the process of selection of students / candidates for WPL. | 12. IPOO preko odgovorno lice organizuju proces selekcije učenika / kandidate za URM; |
| 13. IAAP dhe ndërmarrjet përmes personave përgjegjës koordinojnë zbatimin e MVP-së për profilet përkatëse sipas udhëzuesit operacional të MVP-së. | 13. IVET and enterprises through responsible persons coordinate the implementation of WPL for relevant profiles according to the WPL operational guide. | 13. IPOO i preduzeća preko odgovorna lica koordiniraju sprovođenje URM-a za odgovarajuće profile u skladu sa operativnim vuputstvom URM-a. |
| 14. IAAP mban kontakt dhe bashkëpunon me instruktorin/personin përgjegjës të ndërmarrjes përmes mësimdhënësit të praktikës profesionale/ instruktorit të profilit përkatës. | 14. IVET maintains contact and cooperates with the instructor / responsible person of the enterprise through the professional practice teacher / instructor of the respective profile. | 14. IPOO održava kontakt i sarađuje sa instruktorom / odgovornom osobom preduzeća preko nastavnika profesionalne prakse / instruktora odgovarajućeg profila. |
| 15. IAAP përmes personit përgjegjës përgatitë nxënësit/kandidatët e përzgjedhur për MVP mbi etikën dhe shkathtësitë e buta në vendin e punës. | 15. IVET through the responsible person prepares the students / candidates selected for WPL on ethics and soft skills in the workplace. | 15. IPOO preko odgovorne osobe priprema odabrane učenike/kandidate za URM o etici na radnom mestu i mekim veštinama. |
| **Neni 8**<br>**Përgjegjësitë dhe obligimet e nxënësit/kandidatit në MVP** | **Article 8**<br>**Responsibilities and obligations of the student / candidate in WPL** | **Član 8**<br>**Odgovornosti i obaveze učenika/kandidata u URM** |
| 1. Përgjegjësitë dhe obligimet e nxënësit/kandidatit përcaktohen me kontratën e MVP-së sipas udhëzuesit operacional të MVP-së. | 1. The responsibilities and obligations of the student / candidate are defined by the WPL contract according to the WPL operational guide. | 1. Odgovornosti i obaveze učenika / kandidata utvrđuju se ugovorom za URM prema operativnom uputstvu URM-a. |
| 2. Nxënësi/kandidati nënshkruan kontratën e MVP-së me IAAP-në dhe ndërmarrjen. | 2. The student / candidate, signs the WPL contract with IVET and the enterprise. | 2. Učenik/kandidat potpisuje URM ugovor sa IPOO i preduzećem. |

| | | |
|---|---|---|
| 3. Nxënësi/kandidati respekton kushtet e kontratës së MVP-së.<br><br>4. Nxënësi/kandidati zbaton rregullat dhe rregulloret e brendshme dhe e respekton konfidencialitetin e ndërmarrjes.<br><br>5. Nxënësi/kandidati gjatë procesit të MVP-së kryen me përgjegjësi dhe me kohë detyrat e caktuara.<br><br>6. Nxënësi/kandidati përdorë mjetet dhe resurset e ofruara në mënyrë të përgjegjshme.<br><br>7. Nxënësi/kandidati regjistron të dhënat e MVP-së në portfolion e tij dhe ia prezenton instruktorit/personit përgjegjës në ndërmarrje për verifikim.<br><br>**Neni 9**<br>**Roli dhe përgjegjësitë e ndërmarrjes si partnere në organizimin dhe ofrimin e MVP-së**<br><br>1. Ndërmarrja informon IAAP-në për numrin e nxënësve /kandidatëve për profil që mund të pranojë për MVP, sipas kritereve të përcaktuara në udhëzuesin operacional të MVP-së. | 3. The student / candidate respects the terms of the WPL contract.<br><br>4. The student / candidate, applies the internal rules and regulations and respects the confidentiality of the enterprise.<br><br>5. The student / candidate during the WPL process, performs the assigned tasks responsibly and on time.<br><br>6. The student / candidate uses the tools and resources provided responsibly.<br><br>7. The student / candidate registers the WPL data in his / her portfolio and presents it to the instructor / responsible person in the enterprise for verification.<br><br>**Article 9**<br>**Role and responsibilities of the enterprise as a partner in organizing and providing the WPL**<br><br>1. The enterprise informs the IVET about the number of students / candidates for the profile it can accept for WPL, according to the criteria set out in the WPL operational guide. | 3. Učenik / kandidat poštuje uslove ugovora URM-a.<br><br>4. Učenik / kandidat primenjuje interna pravila i propise i poštuje poverljivost preduzeća.<br><br>5. Učenika/kandidat tokom procesa URM odgovorno i na vreme obavlja utvrđene obaveze.<br><br>6. Učenik/kandidat koristi alate i resurse koje mu obezbedne odgovorno.<br><br>7. Učenik/kandidat evidnetira podatke URM u svoj portofolio i to prezentuje instruktoru/odgovornom licu za URM-a na verifikaciju.<br><br>**Član 9**<br>**Uloga i odgovornosti preduzeća kao partner u organizovanju i omogućavanje URM-a**<br><br>1. Kompanija obaveštava IPOO o broju učenika / kandidata za profil koji može prihvatiti za URM, u skladu sa kriterijumima navedenim u operativnom uputstvu URM-a. |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Ndërmarrja informon nxënësit/kandidatët për rregullat e brendshme të ndërmarrjes dhe siguron kushtet për sigurinë dhe shëndetin gjatë zbatimit të MVP-së, bazuar në legjislacionin në fuqi.<br><br>3. Ndërmarrja verifikon dëshminë që nxënësi e ka të mbuluar sigurimin ndaj aksidentit gjatë realizimit të MVP-së në ndërmarrje.<br><br>4. Ndërmarrja ofron burimet e nevojshme për zbatimin e MVP-së: lëndën e parë, mjetet e punës, burimet njerëzore dhe burime të tjera.<br><br>5. Ndërmarrja gjen modalitete për ofrimin e kompensimit të nxënësve/kandidatëve gjatë MVP-së.<br><br>6. Ndërmarrja në bashkëpunim me IAAP-në përcaktojnë kriteret për përzgjedhjen e nxënësve/kandidatëve për MVP.<br><br>7. Ndërmarrja cakton instruktorin/personin përgjegjës në ndërmarrje për zbatimin e MVP-së.<br><br>8. Ndërmarrja përmes instruktorit/personit përgjegjës në ndërmarrje bashkëpunon me | 2. The enterprise informs students / candidates about the internal rules of the enterprise and provides the conditions for safety and health during the implementation of the WPL, based on the legislation in force.<br><br>3. The enterprise verifies the evidence that the student has insurance against accident during the implementation of WPL in the enterprise.<br><br>4. The enterprise provides the necessary resources for the implementation of WPL: raw materials, tools, human resources and other resources.<br><br>5. The enterprise finds modalities for providing compensation to students / candidates during the WPL.<br><br>6. The enterprise in cooperation with IVET determines the criteria for the selection of students / candidates for WPL.<br><br>7. The enterprise appoints the instructor/person responsible in the enterprise for the implementation of the WPL.<br><br>8. The enterprise through the instructor / responsible person in the enterprise | 2. Preduzeće informiše učenike/kandidate o internim pravilima preduzeća i obezbeđuje uslove za bezbednost i zdravlje tokom sprovođenje URM-a, na osnovu važećeg zakonodavstva.<br><br>3. Preduzeće proverava dokaze da učenik ima osiguranje od nezgode tokom obavljanje URM-a u preduzeću.<br><br>4. Kompanija obezbeđuje potrebne resurse za primenu URM-a: sirovine, radne alate, ljudske resurse i druge resurse.<br><br>5. Kompanija pronalazi modalitete za obezbeđivanje nadoknade učenicima/kandidatima tokom URM-a.<br><br>6. Preduzeće u saradnji sa IPOO određuju kriterijume za izbor učenika / kandidata za URM.<br><br>7. Preduzeće imenuje instruktora / osobu odgovornu u preduzeću za obavljanje URM-a.<br><br>8. Preduzeće preko instruktora / odgovornog lica u preduzeću sarađuje sa nastavnikom |

| | | |
|---|---|---|
| mësimdhënësin e praktikës profesionale/instruktorin nga IAAP-të për hartimin dhe zbatimin e planit të MVP-së. | cooperates with the professional practice teacher / instructor from IVET for the drafting and implementation of the WPL plan. | profesionalne prakse /instruktorom iz IPOO-a za izradu i primenu plana za URM. |
| 9. Ndërmarrja përmes instruktorit /personit përgjegjës në ndërmarrje bën vlerësimin e vazhdueshëm dhe e dorëzon dokumentacionin te mësimdhënësi i praktikës profesionale, i cili bazuar në dokumentacion vendos notën përfundimtare në ditar të klasës. | 9. The enterprise through the instructor / responsible person in the enterprise makes the continuous evaluation and submits the documentation to the teacher of professional practice, which based on the documentation, puts the final grade in the class diary. | 9. Preduzeće preko instruktora / odgovornog lica u preduzeću vrši kontinuirano ocenjivanje i dostavlja dokumentaciju nastavniku profesionalne prakse, koji na osnovu dokumentacije stavlja konačnu ocenu u razredni dnevnik. |
| 10. Me përfundim të MVP-së ndërmarrja i lëshon dëshmi nxënësit/kandidatit për realizimin e MVP-së dhe shkathtësitë e fituara. | 10. Upon completion of the WPL, the enterprise issues a certificate to the student / candidate for the implementation of the WPL and the acquired skills. | 10. Nakon završetka URM-a, preduzeće izdaje potvrdu učeniku /kandidatu za obavljanje URM-a i stečenih veština. |
| **Neni 10**<br>**Përgjegjësitë e instruktorit/personit përgjegjës në ndërmarrje** | **Article 10**<br>**Responsibilities of the instructor / responsible person in the enterprise** | **Član 10**<br>**Odgovornosti instruktora /odgovornog lica u preduzeću** |
| 1. MVP realizohet nën mbikëqyrjen e instruktorit/ personit përgjegjës në ndërmarrje që caktohet nga ndërmarrja. | 1. WPL is implemented under the supervision of the instructor / responsible person in the enterprise appointed by the enterprise. | 1. URM se izvodi pod nadzorom instruktora/ odgovornog lica preduzeća koje imenuje reduzeće. |
| 2. Instruktori/personi përgjegjës në ndërmarrje realizon MVP-në, me jo më tepër se pesë nxënës/kandidatë, ndërsa për profilet me rrezikshmëri të lartë, jo më tepër se tre nxënës/kandidatë. | 2. The instructor / responsible person in the enterprise performs the WPL, with no more than five students / candidates, while for high risk profiles, no more than three students / candidates. | 2. Instruktor/odgovorno lice u preduzeću realizuje URM sa najviše pet učenika / kandidata, dok za visoko rizične profile ne više od tri učenika / kandidata; |

| | | |
|---|---|---|
| 3. Instruktori/personi përgjegjës në ndërmarrje për MVP, merr pjesë në hartimin e planit të MVP-së bazuar në kurrikulën e kualifikimit përkatës në bashkëpunim me mësimdhënësin e praktikës profesionale/instruktorin e shkollës. | 3. The instructor / responsible person in the enterprise for WPL, participates in the drafting of the WPL plan based on the respective qualification curriculum in cooperation with the professional practice teacher / school instructor. | 3. Instruktor/odgovorno lice u preduzeću za URM učestvuje u izradi plana URM-a na su osnovu odgovarajućeg kvalifikacionog kurikuluma u saradnji sa odgovarajućim nastavnikom profesionalne prakse / školskim instruktorom; |
| 4. Instruktori/personi përgjegjës në ndërmarrje për MVP njofton secilin nxënës/kandidat me rregullat e brendshme të ndërmarrjes për ofrimin e MVP-së dhe i udhëzon për masat e sigurisë dhe shëndetit në punë, në përputhje me rregulloret në fuqi. | 4. The instructor / responsible person in the enterprise for WPL informs each student / candidate with the internal rules of the enterprise for providing WPL and instructs them on safety and health measures at work, in accordance with the regulations in force. | 4. Instruktor/odgovorno lice u preduzeću za URM obaveštava svakog učenika / kandidata o unutrašnjim pravilima kompanije za pružanje URM-a i upoznava ih sa merama o bezbednosti i zdravlje na radu, u skladu sa važećim propisima; |
| 5. Instruktori/personi përgjegjës në ndërmarrje për MVP organizon hapësirën e punës për secilin nxënës/kandidat duke siguruar dokumentacionin e duhur teknik dhe teknologjik, mjetet, pajisjet dhe materialet për zbatimin e sigurt të MVP-së. | 5. The instructor / responsible person in the enterprise for WPL organizes the working space for each student / candidate by providing the appropriate technical and technological documentation, tools, equipment and materials for the safe implementation of WPL. | 5. Instruktor/odgovorno lice u preduzeću za URM preduzeću organizuje radni prostor za svakog učenika / kandidata obezbeđujući odgovarajuću tehničku i tehnološku dokumentaciju, alate, opremu i materijale za sigurnu implementaciju URM-a; |
| 6. Instruktori/personi përgjegjës në ndërmarrje për MVP demonstron elemente të veçanta nga procesi i punës dhe cakton detyrat praktike në përputhje me planin e MVP-së. | 6. The instructor / responsible person in the enterprise for WPL, demonstrates specific elements from the work process and assigns practical tasks in accordance with the WPL plan. | 6. Instruktor /odgovorno lice u preduzeću za URM demonstrira posebne elemente iz procesa rada i određuje praktične zadatke u skladu sa planom URM-a; |
| 7. Instruktori/personi përgjegjës në ndërmarrje për MVP, kontrollon zbatimin e detyrave të caktuara, ofron udhëzime | 7. The instructor / responsible person in the enterprise for WPL controls the implementation of certain tasks, provides | 7. Instruktor/odgovorna osoba u preduzeću za URM kontroliše sprovođenje određenih zadataka, pruža praktična uputstva tokom |

| | | |
|---|---|---|
| praktike gjatë procesit të punës dhe vlerëson cilësinë e të zbatuarit. | practical instructions during the work process and evaluates the quality of implementation. | procesa rada i ocenjuje kvalitet implementacije; |
| 8. Instruktori/personi përgjegjës në ndërmarrje për MVP, verifikon dhe miraton të dhënat e regjistruara nga nxënësi/ kandidati në ditarin e punës si dhe e udhëzon nxënësin/kandidatin për mirëmbajtje të portfolios. | 8. The instructor / responsible person in the enterprise for WPL, verifies and approves the data registered by the student / candidate in the work diary as well as instructs the student / candidate for portfolio maintenance. | 8. Instruktor / odgovorna osoba u preduzeću za URM, verifikuje i odobrava registrovane podatke koje je učenik/kandidat zabeležio u rdni dnevnik, kao i upućuje učenika/kandidata za održavanje portofolio. |
| 9. Portfolio e nxënësit/kandidatit përmban dëshmitë relevante të procesit të punës dhe vlerësimit të MVP-së, përfshirë edhe vetëvlerësimin sipas përshkrimit në udhëzuesin e MVP-së. | 9. The student / candidate portfolio contains relevant evidence of the work process and WPL assessment, including self-assessment as described in the WPL guide. | 9. Portofolio učenika/kandidata sadrži relevantne dokaze o procesu rada i ocenjivanje URM-a, uključujući samoocenjivanje kako je opisano u vodiču za URM. |
| 10. Instruktori/personi përgjegjës në ndërmarrje për MVP mban kontakt me IAAP-në përmes mësimdhënësit të praktikës profesionale/instruktorin e shkollës. | 10. Instructor / responsible person in the enterprise for WPL maintain contact with the IVET through the professional practice teacher / school instructor. | 10. Instruktor / odgovorno lice u preduzeću za URM održava kontakt sa IPOO preko nastavnika profesionalne prakse / školskog instruktora. |
| **Neni 11**<br>**Roli i partnerëve social** | **Article 11**<br>**Role of social partners** | **Član 11**<br>**Uloga socijalnih partnera** |
| 1. OEK dhe shoqatat sektoriale lehtësojnë dhe përkrahin ndërlidhjen dhe bashkëpunimin e ndërmarrjeve me IAAP. | 1. KCC and sectoral associations facilitate and support the liaison and cooperation of enterprises with IVET. | 1. PKK i sektorska udruženja olakšavaju i podržavaju vezu i saradnju preduzeća sa IPOO. |
| 2. OEK mbledh të dhëna për marrëveshjet dhe kontratat e MVP-së dhe zbatimin e tyre. | 2. KCC collects data on agreements and contracts of WPL and their implementation. | 2. PKK prikuplja podatke o sporazumima i ugovorima sa URM i njihovoj primeni. |

| | | |
|---|---|---|
| 3. OEK përditëson databazën për ndërmarrjet e përfshira ne zbatimin e MVP-së. | 3. KCC updates the database for enterprises involved in the implementation of WPL. | 3. PKK ažurira bazu podataka za preduzeća uključena u primenu URM-a. |
| **Neni 12**<br>**Procedura e pranimit të nxënësve/kandidatëve për MVP** | **Article 12**<br>**Admission procedure for students / candidates for WPL** | **Član 12**<br>**Procedura prijema učenik/kandidata za URM** |
| 1. MVP ofrohet në ndërmarrje sipas procedurave të pranimit për nxënësit/kandidatët të cilët i kanë mbushur 15 vjet. | 1. WPL is offered in the enterprise according to the admission procedures for students / candidates who have reached 15 years of age. | 1. URM se nudi u preduzeću prema procedurama prijema za učenike/kandidate koji su navršili 15 godina. |
| 2. Thirrja për aplikim për ndërmarrje duhet të jetë e hapur gjatë tërë vitit shkollor në mënyrë që ndërmarrja ta informojë IAAP-në për mundësitë e krijuara për MVP përgjatë tërë vitit shkollor. | 2. The call for enterprise application must be open throughout the school year so that the enterprise informs the IVET of the opportunities created for WPL throughout the school year. | 2. Poziv za prijave preduzeća trebalo bi da bude otvoren tokom čitave školske godine, tako da preduzeće obaveštava IPOO-a o mogućnostima stvorenim za URM tokom čitave školske godine. |
| 3. Ndërmarrja informon me shkrim IAAP-të për numrin e vendeve të lira për sistemimin e nxënësve/kandidatëve në MVP. | 3. The company informs in writing the IVET about the number of vacancies for the systematization of students / candidates in WPL. | 3. Kompanija pismeno obaveštava IPOO o broju slobodnih mesta za ssistematizaciju učenika/kandidata u URM. |
| 4. IAAP së bashku me ndërmarrjen i informojnë nxënësit dhe prindërit/kujdestarët e tyre me mundësitë që lidhen me MVP sipas kritereve të përzgjedhjes. | 4. IVET together with the enterprise informs students and their parents / guardians about the opportunities related to WPL according to the selection criteria. | 4. IPOO zajedno sa kompanijom obaveštava učenike i njihove roditelje / staratelje o mogućnostima vezano za URM prema kriterijumima za izbor. |
| 5. Ndërmarrja konfirmon pranimin e nxënësve të përzgjedhur jo më vonë se tre | 5. The enterprise confirms the admission of selected students no later than three months | 5. Kompanija potvrđuje prijem izabranih učenika najkasnije tri meseca pre početka |

| | | |
|---|---|---|
| muaj para fillimit të çdo viti shkollor. | before the start of each school year. | svake školske godine. |
| 6. IAAP shpall listën e nxënësve/kandidatëve të përzgjedhur për MVP. | 6. IVET announces the list of students / candidates selected for WPL. | 6. IPOO objavljuje listu učenika/kandidata izabranih za URM. |
| 7. Nxënësit/kandidatët nënshkruajnë kontratën e MVP-së me ndërmarrjen dhe IAAP-në pas përzgjedhjes. | 7. Students / candidates sign the WPL contract with the enterprise and IVET after selection. | 7. Učenici/kandidati potpisuju ugovor URM-a sa kompanijom i IPOO po izboru. |
| **Neni 13**<br>**Kohëzgjatja dhe zbatimi** | **Article 13**<br>**Duration and implementation** | **Član 13**<br>**Vreme trajanja primene** |
| 1. MVP mund të zbatohet përgjatë viteve shkollore, bazuar në kurrikulën e profileve përkatëse dhe fushëveprimtarinë e ndërmarrjes. | 1. WPL can be implemented throughout the school years, based on the curriculum of the respective profiles and the scope of the enterprise. | 1. URM se može realizovati tokom školske godine, na osnovu kurikuluma odgovarajućih profila i oblast delovanja preduzeća. |
| 2. Kohëzgjatja e MVP-së është e përcaktuar në kurrikulë, përkatësisht tek modulet profesionale të kualifikimit përkatës. | 2. The duration of WPL is defined in the curriculum, respectively in the professional modules of the respective qualification. | 2. Vremenski period trajanja URM je definisan u kurikulum, odnosno u profesionalnim modulima dotične prkatse, |
| 3. IAAP dhe ndërmarrja caktojnë orarin varësisht nga specifikat e sektorit, profilit përkatës dhe sipas mundësisë së ndërmarrjes. | 3. IVET and the enterprise set the schedule depending on the specifics of the sector, the relevant profile and according to the enterprise possibility. | 3. IPOO i preduzeće postavljaju raspored u zavisnosti od specifičnosti sektora, odgovarajućeg profila i prema mogućnostima preduzeća. |
| 4. MVP zbatohet me orarin bllok varësisht nga kërkesat e ndërmarrjes dhe specifikat e profilit të kualifikimit përkatës; | 4. WPL is implemented with block schedule depending on the requirements of the enterprise and the specifics of the respective qualification profile. | 4. URM se primenjuje prema blok rasporedu u zavisnosti od zahteva preduzeća i specifičnosti odgovarajućeg profila kvalifikacije; |

| | | |
|---|---|---|
| 5. Instruktori/personi përgjegjës në ndërmarrje, zbaton planin e MVP-së, të zhvilluar paraprakisht në bashkëpunim me mësimdhënësin e praktikës profesionale/instruktorin e shkollës. | 5. The instructor / responsible person in the enterprise, implements the WPL plan, developed in advance in cooperation with the professional practice teacher / school instructor. | 5. Instruktor/odgovorno lice u preduzeću sprovodi plan URM-a, unapred razvijen u saradnji sa nastavnikom profesionalne prakse/školskim instruktorom. |
| **Neni 14**<br>**Ndërprerja e marrëveshjes dhe shkëputja e kontratës** | **Article 14**<br>**Termination of the agreement and termination of the contract** | **Član 14**<br>**Prekid ugovor i raskidanje ugovora** |
| 1. Në rast të mosrespektimit të obligimeve që dalin nga marrëveshja e MVP-së, IAAP apo ndërmarrja, ka të drejtë për ndërprerje të marrëveshjes. | 1. In case of non-compliance with the obligations arising from the WPL agreement, the IVET or the enterprise has the right to terminate the agreement. | 1. U slučaju nepoštovanja obaveza koje proističu iz ugovora, o URM, IPOO ima pravo da prekine ugovor; |
| 2. Ndërprerja e marrëveshjes në mes të palëve, mund të ekzekutohet pasi të informohen të dyja palët me shkrim mbi arsyen, së paku 30 ditë kalendarike para shkëputjes. | 2. Termination of the agreement between the parties may be executed after informing both parties in writing of the reason, at least 30 calendar days before the termination. | 2. Prekid ugovora između stranaka može se izvršiti nakon što su obe strane pismeno informišu o razlogu, najmanje 30 kalendarskih dana pre prekida; |
| 3. Në rast të mosrespektimit të obligimeve që dalin nga kontrata e MVP-së, IAAP, ndërmarrja apo nxënësi/kandidati, ka të drejtë për ndërprerje të kontratës. | 3. In case of non-compliance with the obligations arising from the WPL contract, the IVET, the enterprise or the student / candidate, has the right to terminate the contract. | 3. U slučaju nepoštovanja obaveza koje proističu iz ugovora za URM, IPOO, preduzeće ili učenik/kandidat, ima pravo da prekine ugovor; |
| 4. Në rast të shkeljes së kontratës së MVP-së, nxënësi apo ndërmarrja kanë të drejtë ankese në IAAP. | 4. In case of violation of the WPL contract, the student or enterprise has the right to appeal to the IVET. | 4. U slučaju kršenja URM-a, učenik ili preduzeće ima pravo žalbe u IPOO. |
| 5. IAAP duhet t'a adresojë ankesën e | 5. IVET should address the student / | 5. IPOO treba da uputi žalbu |

| | | |
|---|---|---|
| nxënësit/kandidatit tek ndërmarrja përkatëse apo anasjelltas.<br><br>6. Në raste specifike ankesa duhet të adresohet në DKA apo AAAPARr.<br><br>7. Ndërprerja e kontratës në mes të palëve mund të ekzekutohet pasi të informohen palët me shkrim mbi arsyen, së paku 15 ditë kalendarike para shkëputjes.<br><br>**Neni 15**<br>**Vlerësimi, përfundimi dhe dëshmia e MVP-së**<br><br>1. Vlerësimi i rezultateve të arritura nga nxënësi/kandidati bëhet në vazhdimësi bazuar në planin e MVP-së.<br><br>2. Vlerësimi bëhet nga instruktori/personi përgjegjës i ndërmarrjes në përputhshmëri me kriteret vlerësuese të planit të MVP-së.<br><br>3. Mësimdhënësi për praktikë profesionale/instruktori i IAAP-së, vendos notën përfundimtare, bazuar në vlerësimin e MVP-së nga instruktori/ personi përgjegjës në ndërmarrje.<br><br>4. Portfoliot me dëshmitë dhe vlerësimet e | candidate's complaint to the relevant enterprise or vice versa.<br><br>6. In specific cases the complaint should be addressed to MED or AVETAE.<br><br>7. Termination of the contract between the parties may be executed after informing the parties in writing of the reason, at least 15 calendar days before the termination.<br><br>**Article 15**<br>**Evaluation, conclusion and evidence of WPL**<br><br>1. The evaluation of the results achieved by the student / candidate is done continuously based on the WPL plan.<br><br>2. The evaluation is done by the instructor / responsible person of the enterprise in accordance with the evaluation criteria of the WPL plan.<br><br>3. Professional practice teacher / IVET instructor decides the final grade, based on the evaluation of WPL by the instructor / responsible person in the enterprise.<br><br>4. Portfolio with student / candidate | učenika/kandidata relevantnom preduzeću ili obrnuto.<br><br>6. U određenim slučajevima žalbu treba uputiti ODO-u ili APOOO.<br><br>7. Prekid ugovora između strana može se izvršiti nakon što se stranke pismeno obaveste o razlogu, najmanje 15 kalendarska dana pre raskida.<br><br>**Član 15**<br>**Ocenjivanje, završetak i dokaz URM-a**<br><br>1. Ocenjivanje rezultata koje je postigao učenik/kandidat vrši se kontinuirano na osnovu plna o URM.<br><br>2. Ocenjivanje vrši instruktor/odgovorno lice preduzeća u skladu sa kriterijumima ocenjivanja iz plana URM.<br><br>3. Nastavnik za profesionalnu praksu/instruktor IPOO-a odlučuje o konačnoj oceni, na osnovu proceni URM-a od strane instruktora/odgovornog lica u preduzeću;<br><br>4. Portfolijo sa dokazima i ocene učenika / |

| | | |
|---|---|---|
| nxënësit/kandidatit pas përfundimit të MVP-së mbahen në IAAP. | testimonies and assessments after completion of WPL are held at IVET. | kandidata nakon završetka URM-a predaju se IPOO. |
| **Neni 16**<br>**Monitorimi dhe raportimi** | **Article 16**<br>**Monitoring and reporting** | **Član 16**<br>**Monitoring i izveštavanje** |
| 1. Gjatë realizimit të MVP-së, monitorimi i nxënësve/kandidatëve, realizohet nga mësimdhënësi i praktikës profesionale/instruktori i IAAP-së. | 1. During the implementation of the WPL, the monitoring of students / candidates is carried out by the professional practice teacher / IVET instructor. | 1. Tokom realizacije URM-a, monitoring učenika / kandidata vrši nastavnik/instruktor profesionalne prakse IPOO-a; |
| 2. Mësimdhënësi i praktikës profesionale/instruktori i IAAP-së monitoron procesin përmes formave të ndryshme të monitorimit dhe përmes vizitave në ndërmarrje, së paku një herë në dy javë. | 2. The professional practice teacher / IVET instructor monitors the process through various forms of monitoring and through company visits, at least once every two weeks. | 2. Nastavnik profesionalne prakse/instruktor IPOO-a nadgleda proces kroz različite oblike monitoringa i kroz posete preduzeću, najmanje jednom u dve nedelje. |
| 3. Mësimdhënësi i praktikës profesionale i IAAP-së, i raporton personit përgjegjës dhe menaxhmentit të IAAP-së për ecurinë e MVP-së. | 3. The IVET professional practice teacher reports to the responsible person and the IVET management on the WPL progress. | 3. Nastavnik profesionalne prakse IPOO-a izveštava odgovornu osobu i rukovodstvo IPOO-a o napretku URM-a. |
| 4. Personi përgjegjës i IAAP-së, harton raportin vjetor për realizimin e MVP-së, bazuar në informatat e monitorimit nga mësimdhënësi i praktikës profesionale/instruktori i IAAP-së dhe e dorëzon tek menaxhmenti i IAAP-së. | 4. The responsible person of IVET drafts the annual report for the implementation of WPL, based on the monitoring information from the professional practice teacher / IVET instructor and submits it to the IVET management. | 4. Odgovorno lice IPOO-a sastavlja godišnji izveštaj o realizaciji URM-a, na osnovu informacija o monitoringu od strane nastavnika/instruktora profesionalne prakse IPOO-a i dostavlja menadžmentu IPOO-a; |
| 5. Procesi i MVP-së, monitorohet nga institucionet perkatese qendrore dhe lokale. | 5. The WPL process is monitored by relevant central and local institutions. | 5. Proce URM, nadgledaju od strane relevantnih centralnih i lokalnih institucija. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 17**<br>**Financimi**<br><br>Mbulesa e shpenzimeve dhe pagesa e nxënësve/kandidatëve rregullohet me kontratën e MVP-së.<br><br>**Neni 18**<br>**Hyrja në fuqi**<br><br>Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.<br><br>**Ramë Likaj,**<br>_______________<br>**Ministër**<br>**Dt.** 23 . __ . 2020 | **Article 17**<br>**Funding**<br><br>Expenses and payment of students / candidates are regulated by the WPL contract.<br><br>**Article 18**<br>**Entry into force**<br><br>This Administrative Instruction enters into force fifteen (15) days after publication in the Official Gazette of the Republic of Kosova.<br><br>**Ramë Likaj,**<br>_______________<br>**Minister**<br>**Date**____.____.________ | **Član 17**<br>**Finansiranje**<br><br>Pokrivenost rashoda i isplata učeniku / kandidatu reguliše se ugovorom o URM.<br><br>**Član 18**<br>**Stupanje na snagu**<br><br>Ovaj Administrativno uputstvo stupa na snagu petnaest (15) dana nakon objavljivanja u Službenom glasniku Republike Kosovo.<br><br>**Ramë Likaj,**<br>_______________<br>**Ministar**<br>**Dat.**___.____.________ |

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIC OF KOSOVO • REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY
Prishtinë/a